

## Raporti Perfundimtar

Per

Vleresimin e punes se kryer ne

**Sektorin e Zhvillimit te Tokes, Mbrojtjes se Mjedisit dhe Monitorimit te Investimeve**

**Bashkia Devoll**

### I. PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbeshtetur ne ligjin nr. 114 date: 22/10/2015 "Per auditimin e brendshem ne sektorin publik", Manualit te auditit te brendshem te miratuar me urdherin nr.100 Date:25.10.2016 te Ministrit te Financave, Manualit te auditimit te brendshem te miratuar me urdherin nr.100 Date:25.10.2016 te Ministrise se Financave, planin vjetor te auditit te brendshem nr.prot 2610/1 date 16.10.2018 te miratuar nga kryetari i bashkise Devoll, njoftim per fillimin e angazhimit te auditimit nr 2377 Prot, date 24.07.2019 "Mision auditimi i perputhshmerise ne **Sektorin e Zhvillimit te Tokes, Mbrojtjes se Mjedisit dhe Monitorimit te Investimeve**",u krye gjate periudhes 01.08.2019-23.09.2019,per periudhen nga data 01.03.2017-28.06.2019.Auditimi u krye nga specialisti ne zyren e Auditimit te Brendshem Z.Eduard Shaholli.

Misoni i ketij auditimi eshte vleresimi i frytshmerise te procesit te menaxhimit te riskut, dhenia e sigurise ,eshte synimi per te shtuar vleren dhe per te permiresuar kontrollin.Nga auditimi i kryer ne **Sektorin e Zhvillimit te Tokes dhe mbrojtjes se Mjedisit**,eshte vleresuar ne teresi sistemi ne perputhje me udhezimet dhe metodikat me qellim qe sistemi i kontrollit te njesise te audituar,te jene transparente dhe ne perputhje me normat e ligjshmerise, rregullshmerise, frytshmerise dhe kursimit.Jane realizuar te gjitha pikat e programit te pergatitura nga specialistet e auditit.

Po bejme te qarte ne fillim termat qe do te perdoren pasi deri ne Qershor te vitit 2015 Bashkia emertohej bashkia Bilisht dhe kishte juridiksionin e saj vetem brenda qytetit te Bilishtit.Atehere bashkia nuk e kishte ne nivel sektori por kishte ne perberje Zyren qe quhej **Zyra e Menaxhimit te Tokes** e cila kryente sherbimet me vetem nje specialist.Por mbas zgjedhjeve te qershorit 2015 me implementimin e reformes teritoriale rethi i Devollit ka vetem nje bashki te quajtur bashkia Devoll e cila ka ne perberje edhe 4 njesite administrative.Njekohesisht me ndryshimin e struktures se bashkise ndryshuan edhe emertimet e sektoreve dhe drejtorive dhe qe nga viti 2016 zyra e

Menaxhimit të Tokes u emertua si **Spektori i Zhvillimit të Tokes ,Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve** me strukture të miratuar prej 4 personash duke përfshirë 3 specialiste dhe një përgjegjës.

*Qellimi* i angazhimit të auditimit është vlerësimi dhe dhënia e sigurisë objektive, të pavarur mbi veprimtarinë në **Spektori i Zhvillimit të Tokes dhe mbrojtjes së Mjedisit**. për të vlerësuar efektivitetin dhe efikasitetin për arritjen e objektivave të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm dhe njëkohësisht dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e shërbimit.

**Në përfundim të auditimit në Sektorin e Zhvillimit të Tokes, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Monitorimit të Investimeve janë konstatuar shkelje të akteve ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me sistemin e kthimit të përgjigjeve të korespondencave zyrtare, në sistemin e mosplotësimit të struktureve organike për një kohë të gjatë, në sistemin e mbajtjes së procesverbalëve për rastet e nderhyrjeve në token bujqësore, në sistemin e indentifikimit dhe hartimit të risqeve të sektorit, në sistemin e mosfunksionimit të kontrollit të brendshëm.**

*-Në sistemin e ndarjes së detyrave* u konstatua se gjatë periudhës Mars 2017 – Maj 2019 një nr i madh kërkesash për plotësim dokumentacioni të erdhura nga ZVRPP Devoll nuk kanë marrë përgjigje. Përgjegjësi i sektorit së bashku me specialistet përkatës duhet të ndjekin në vazhdimësi korespondencën

*-Në sistemin e hartimit dhe raportimit të planeve operacionale vjetore.*

Nuk janë hartuar planet operacionale dhe raportet mujore dhe vjetore me qëllim që të shihet realizimi i objektivave dhe të meren masa për përmirësim në të ardhmen.

Nuk ka informacion të protokolluar mbi realizimin e detyrave dhe përmbushjen e objektivave vjetore.

*-Në sistemin e plotësimit të Struktureve* organike u konstatua se Spektori për një kohë të gjatë ka funksionuar pa përgjegjës dhe me mungesë të theksuar të specialistëve duke sjellë vonesa në shërbimin ndaj komunitetit.

*-Në Sistemin e hartimit dhe mbajtjes së dokumentacionit* konstatua se nuk ishte mbajtur asnjë procesverbal dhe nuk ishte ushtruar asnjë kontroll në token bujqësore për të evidentuar rastet e ndertimeve pa leje.

-Ne sistemin e hartimit te objektivave dhe risqeve te sektorit u kostatua se sektori nuk ka te indentifikuar risqet e realizimit te objektivave te cilat me vone perdoren ka kordinatori i riskut per hartimin e regjistrimit te pergjithshem te riskut.

Nga ana e specialisteve te auditimit per gjetjet e mesiperme jane dhene rekomandimet perkatese ne seksionet me poshte per permiresimin e punes ne te ardhmen nga ky sektor.

## **VI. Rekomandimet**

Ne perfundim te procesit te vleresimeve te bera nga specialistet e auditimit per personat pergjegjes bazuar ne nenin 6 pika c e Ligjit nr 114/2015 date 22.10.2015 “Per auditimin e brendshem ne sektorin publik” per aritjen e objektivave te **Sektorit te Zhvillimit te Tokes, Mbrojtjes se Mjedisit dhe monitorimit te Investimeve** si dhe per te ritur efektivitetin ne punen funksionimin dhe drejtimin e ketij sektori, **rekomandojme.**

*1. Te meren masa qe te plotesohet struktura e Sektorit te Zhvillimit te Tokes, Mbrojtjes se Mjedisit dhe Monitorimit te Investimeve me pergjegjes Sektori dhe 2 Specialiste ne mynyre qe te mos kemi nderprerje te sherbimit dhe funksionim te kontrollit te brendshem.*

*Personat pergjegjes: Pergjegjesi i Sektorit te burimeve*

*Njerezore, Menaxhimi i Larte*

*Afati: Menjehere*

*2. Punesimi nga ana e Bashkise Devoll e nje specialisit topograf te autorizuar per hartimin e planeve te rilevimit ne mynyre qe ti sherbehet komunitetit te rethit te Devollit per problematikat e dala ne kete sektor.*

*Personat pergjegjes: Menaxhimi i Larte*

*Pergjegjesi i Sektorit te burimeve Njerezore*

*Afati: Menjehere*

*3.Sektori te mare masa qe per cdo rast kthimi i pergjigjeve te shkresave zyrtare te behet brenda afatit te caktuar dhe ne asnje rast te mos ekzistojte dokument apo shkrese e cila nuk ka mare pergjigje.*

*Personat pergjegjese: I gjithe Sektori*

*Afati:Ne vazhdimesi*

*4.Te mbahet procesverbal per cdo rast te evidentimit te ndertimeve te paligjeshme ne token bujqesore apo kontrole te ushtruara ne teren.*

*Personi pergjegjese:Specialisti i mbrojtjes*

*dhe Menaxhimit te tokes*

*Afati:Ne vazhdimesi*

*5.Per funksionimin normal dhe ne vazhdimesi te procesit te menaxhimit te riskut Sektori menjehere duhet te indentifikoje dhe hartoje regjistrin me risqet e objektivave te ketij Sektori.*

*Personi pergjegjese:Pergjegjesi i Sektorit,ne*

*mungese nje specialist sektori*

*Afati:Menjehere.*

**Specialisti i Auditimit te Brendshem**